



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPSTINA LIPJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 19 paragrafi 3. të Ligjit Nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 85/2010, nenit 12 par.12.2 dhe 17 pika e) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/2008) dhe nenit 20 pika d) të Statutit të Komunës së Lipjanit Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur më 31.03.2022, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës mori këtë:

V E N D I M

PËR MBROJTJEN E VLERËS SË NATYRËS: "BURIMET E UJIT" NË FSHATIN BAICË - SI MONUMENT I NATYRËS

- Me këtë Vendim merret nën mbrojtje vlera e natyrës "**Burimet e Ujit**", në fshatin Baicë të Komunës së Lipjanit, si Monument i Natyrës i karakterit hidrologjik (këtu e tutje: Monumenti i Natyrës).
 - Monumenti i Natyrës me hapësirën përfshirëse prej 10 metra përfshinë sipërfaqen prej 5 ari.
 - Monumenti i Natyrës ka vlera natyrore të cilat i japin pamje karakteristike territorit të komunës së Lipjanit por edhe më gjerë.
- Monumenti i Natyrës gjendet në pronë shoqërore, në parcelën 00001-0, zona kadastrale Baicë, nr. P-71409004-00001-0, me sipërfaqe 1585070 m², e regjistruar si pronë shoqërore.
- Monumenti i Natyrës sipas IUCN-it kategorizohet si vlerë e natyrës e kategorisë së III-të, Natural Monument/Natural Landmark – Monument i Natyrës.
- Për Monumentin e Natyrës përcaktohet regjimi i shkallës së III-të të mbrojtjes në të cilën përcaktohen masat dhe kushtet vijuese me të cilat në monumentin e natyrës ndalohet:
 - Veprimtaritë të cilat e ndryshojnë gjendjen e tanishme të tij;
 - Ndezja e zjarrit në sipërfaqen e mbrojtur;
 - Mbjellja e bimëve me qëllim të gjelbërimit të sipërfaqes së mbrojtur;
 - Ndryshimi i pamjes së sipërfaqes së mbrojtur;

4.5. Grumbullimi i mbeturinave në sipërfaqen e mbrojtur;

4.6. Aktivitetet të tjera të cilat mund të shkaktojnë ndryshime ose dëmtime të Monumentit të Natyrës;

4.7. Lëshimi i ujërave të ndotura, deponimi i mbeturinave dhe mbetjeve të tjera;

4.8. Përdorimi i mjeteve mbrojtëse kimike;

4.9. Mbjellja e bimëve ose ngritja e objekteve të cilat mund të ndikojnë në pengimin e pamjes së Monumentit Natyror.

5. Monumenti i Natyrës dhe hapësira rrethuese mund të rregullohet dhe të shfrytëzohet për qëllime të prezantimit me kusht që destinimet e reja nuk e rrezikojnë Monumentin e Natyrës.

5.1. Në Monumentin e Natyrës lejohen:

5.1.1. Të gjitha masat e mbrojtjes teknike të Monumentit Natyror nën kushtet të cilat i përcakton Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës dhe në bazë të projektit për sanimin e gjendjes së Monumentit Natyror si dhe punët teknike të cilat janë në funksion të mbrojtjes të Monumentit Natyror.

6. Për zbatimin e masave dhe kushteve të përcaktuara, kujdeset komuna e Lipjanit, përmes drejtorisë përkatëse.

6.2. Komuna është e detyruar që:

6.1.2. Monumentin e Natyrës ta mbroj, ta ruaj dhe mirëmbajë në pajtim me kushtet e përcaktuara të mbrojtjes;

6.1.3. Në rast të paraqitjes së ndryshimeve të cilat Monumentin e Natyrës mund ta shkatërrojnë ose t'i dëmtojnë vetitë e rëndësishme të tij, menjëherë të lajmëroj Institutin e Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës;

6.1.4. Të bëjë shënjimin e kufijve të Monumentit Natyror në pajtim me Rregulloren për shënjimin e zonave të mbrojtura.

7. Planet hapësinore dhe urbanistike, projektet hidro-teknike duhet të harmonizohen me masat dhe kushtet për mbrojtjen e Monumentit Natyror.

8. Vendimi shpallet pesëmbëdhjetë (15-të) ditë pas regjistrimit në zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe hyn në fuqi shtatë (7-të) ditë pas publikimit në gjuhën zyrtare dhe në web-faqen zyrtare të komunës së Lipjanit.

Nr. 15-352/03-17249

Lipjan, më 31.03.2022

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi





Na osnovu člana 19 stav 3. Zalkona Br. 03/L-233 za Zaštitu Prirode ("Službena Novina Republike Kosova" Br. 85/2010, člana 12 stav 12.2 i člana 17 tačka e) Zakona Br. 03/L-040 o Lokalnoj Samoupravi ("Službena Novina Republike Kosova" Br. 28/2008) i člana 20 tačka d) Statuta Opštine Lipljana Br.110-78095 dt. 24.12.2021, Skupština Opštine Lipljan na sednici održanoj 31.03.2022, nakon razmatranja predlog Odluke Predsednik Opštine donosi:

ODLUKU
ZA ZAŠTITU VREDNOSTI PRIRODE: „RESURSI VODA“ U SELU BAICA – KAO
SPOMENIK PRIRODE

1. Ovom Odlukom uzima se pod zaštitu vrednost prirode „resursi voda“, u selu Baica, Opštine Lipljan, kao spomenik prirode hidrološkog karaktera (u daljem tekstu: spomenik prirode).
 - 1.1. Spomenik prirode sa obuhvaćenim prostora od 10 metara obuhvata površinu od 5 ari.
 - 1.2. Spomenik prirode ima prirodne vrednosti koji daju karakterističan pogled na teritoriju opštine Lipljan ali i šire.
2. Spomenik Prirode nalazi se na društvom imovinu, u parceli 00001-0, katastarska zona Baicu, br. P-71409004-00001-0, sa površinom 1585070 m², registrovana kao društva imovina
3. Spomenik Prirode prema IUCN kategorisana kao vrednost prirode kategorije III, Natural Monument/Natural Landmark – Spomenik Prirode.
4. Za Spomenik Prirode utvđuje regim III stepenica zaštite na kojem utvđuju se mere i sledeći uslovi sa kojima se u spomeniku prirode zabranuje:
 - 4.1. Aktivnosti koje menjaju njegovo trenutno stanje;
 - 4.2. Paljenje vatre na zaštićenoj površini;
 - 4.3. Sadnja biljaka u cilju ozelenjavanja zaštićenog površina;
 - 4.4. Promena izgleda zaštićene površine;
 - 4.5. Sakupljanje smeća na zaštićenoj površini;
 - 4.6. Druge aktivnosti koje mogu izazvati izmene ili oštećenja spomenika prirode;
 - 4.7. Ispuštanje otpadnih voda, odlaganje otpada i drugog otpada;
 - 4.8. Upotreba hemijske zaštitne opreme;
 - 4.9. Sadnja biljaka ili podizanje objekata koji mogu uticati na smetanje pogleda na spomenik prirode.
5. Spomenik Prirode i okolni prostor mogu se uređivati i koristiti u svrhu prezentacije pod uslovom da nove destinacije ne ugrožavaju spomenik prirode.


- 5.1. U spomeniku prirode su dozvoljeni:
- 5.1.1. Sve mere tehničke zaštite Spomenika Priroda pod uslovima koje utvrđuje Kosovski Institut za zaštitu prirode i na osnovu projekta sanacije spomenika prirode kao i tehničke radove koji su u funkciji zaštite spomenika prirode.
6. Za sprovođenje mere i određene uslovi, starače se opština Lipljan, preko nadležene direkcije.
- 6.2. Opština je dužna da:
- 6.1.2. Zaštiti, čuvati i održavati spomenik prirode u skladu sa utvrđenim uslovima zaštite;
- 6.1.3. U slučaju bilo kakvih promena koje mogu uništiti spomenik prirode ili oštetiti njegova važna svojstva, odmah obavestiti Kosovski Institut za Zaštitu Prirode;
- 6.1.4. Označiti granice spomenika prirode u skladu sa Pravilnikom o obeležavanju zaštićenih područja.
7. Prostorni i urbanistički planovi, hidrotehnički projekti moraju biti usklađeni sa merama i uslovima zaštite spomenika prirode.
8. Odluka se objavljuje petnaest (15) dana nakon registracije u Kancelariji za protokol Ministarstva administracije lokalne samouprave i stupa na snagu sedam (7) dana od dana objavljivanja na službenom jeziku i na zvaničnom sajtu opštine Lipljan.

Br. 15-352/03-17249

Lipljan, 31.03.2022

SKUPŠTINA OPŠTINE LIPLJAN





Map Spomenika Prirode “Resursi Voda”, u Baicu